



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 1465 Prot

Vlorë, më 22.01 2026

**Informacion mbi raportin vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së
Këshillit të Bashkisë Vlorë për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2025.**

Të nderuar këshilltarë!

Informacioni mbi raportin vjetor të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë ka rëndësi të veçantë për t'u njohur nga anëtarët e Këshillit. Po aq e rëndësishme është edhe njohja e këtij raporti nga komuniteti dhe media, veçanërisht në kuadër të parimit të transparencës. Ky raport shërben njëkohësisht si instrument llogaridhënieje i Këshillit të Bashkisë lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij si organ përfaqësues dhe vendimmarrës, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Gjithashtu, ky informacion përbën detyrim të parashikuar në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë", neni 111, pika 3.

Theksojmë se gjatë vitit 2025 aktiviteti dhe vendimmarrja e Këshillit të Bashkisë kanë pasur specifika të veçanta, të ndikuara edhe nga zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme dhe atyre të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Vlorë, pas dorëheqjes së ish-kryetarit.

Para se të paraqesim një analizë të detajuar të aktiviteteve dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë për periudhën raportuese, theksojmë se në çdo rast është synuar që çdo vendimarrje të ketë impakt pozitiv për komunitetin, pa u ndikuar nga përkatësia etnike apo politike, si dhe nga përkatësia politike e këshilltarëve, e Kryetarit të Bashkisë apo e aktorëve të tjerë propozues. Kjo, sigurisht, nuk ka përjashtuar debatin politik në çdo mbledhje të Këshillit të Bashkisë gjatë procesit vendimmarrës.

Gjithashtu, për çdo vendim të miratuar nga Këshilli i Bashkisë janë zhvilluar konsultime me publikun dhe grupet e interesit, kur dispozitat ligjore e kanë parashikuar këtë si të detyrueshme. Kërkesat dhe propozimet janë marrë parasysh, sa herë që ka qenë e mundur. Në vijimësi, Këshilli i Bashkisë ka kërkuar bashkëpunim nga Administrata e Bashkisë, me qëllim që çdo vendimarrje të jetë në përputhje me interesin publik dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Nëpërmjet kërkesave formale me shkrim ose gjatë mbledhjeve të këshillit, këshilltarët kanë kërkuar informacion nga administrata e Bashkisë, me synimin për të zgjidhur problematika apo shqetësime të ngritura nga komuniteti. Në këtë drejtim, vlerësojmë se Administrata e Bashkisë duhet të tregojë më shumë angazhim për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave, të cilat nuk janë për interesa personale, por si përcjellje e shqetësimeve të qytetarëve.

Funksionimi dhe vendimmarrja e Këshillit të Bashkisë

Gjatë periudhës raportuese, bashkëpunimi i Këshillit të Bashkisë me Kryetarin dhe Administratën e Bashkisë është reflektuar pozitivisht në procesin vendimmarrës. Është tregues pozitiv fakti që gjatë vitit 2025 nuk ka pasur asnjë vendim të Këshillit të Bashkisë të kontestuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe asnjë vendim për të cilin Prefekti i Qarkut të jetë shprehur negativisht lidhur me ligjshmërinë.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi, nuk ka pasur raste të mosmiratimit nga shumica e këshilltarëve të projektvendimeve të parashikuara në rendin e ditës. Megjithatë, në dy raste, projektvendimet:

- “Për dhënien e dakortësisë për nisjen e procedurave për kalimin në pronësi të bashkisë të disa pasurive”, dhe
- “Për nisjen e procedurave për dhënien në përdorim me afat 10-vjeçar të disa pasurive”

janë tërhequr nga Administrata, pas vërejtjeve të bëra nga këshilltarët në mbledhjet e komisioneve të përhershme.

Po ashtu, dy projektvendime të tjera nuk u miratuan për mungesë kuorumi në mbledhjen përkatëse, por u miratuan në mbledhjen pasardhëse të këshillit.

Mbledhjet e Këshillit

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithsej 15 mbledhje të Këshillit të Bashkisë, nga të cilat:

- 12 mbledhje të rregullta, sipas parashikimit të rregullores;
- 2 mbledhje të jashtëzakonshme, të kërkuara nga Kryetari i Bashkisë;
- 1 mbledhje për shpalljen e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.

Mbledhja e rregullt e muajit prill nuk u zhvillua në datën e parashikuar për shkak të mungesës së kuorumit dhe u mbajt një ditë më vonë.

Vendimet e Këshillit

Gjatë vitit 2025 janë miratuar gjithsej 109 vendime, sipas fushave përkatëse, si më poshtë:

- Ndihmë ekonomike – 26 vendime

- Emergjenca civile – 21 vendime
- Buxheti dhe ndryshimet – 13 vendime
- Shërbime dhe strehim – 10 vendime
- Emërtim rrugësh dhe tituj nderi – 10 vendime
- Probleme pronësie – 8 vendime
- Funksionimi i Këshillit të Bashkisë – 9 vendime
- Të tjera – 12 vendime

Në këtë pikë janë vendime për pagat e punonjësve, për numrin e punonjësve në institucionet e varësisë, miratim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera etj. Gjatë kësaj periudhe, vendimet të cilët prekin çështje sociale si, ato për ndihëmën ekonomike, për emergjencat civile dhe për titujt vendorë të nderit, pavarësisht përfaqësimit politik të këshilltarëve janë miratuar në unanimitet nga gjithë këshilltarët e pranishëm në mbledhje. Ndërkohë, vendimet për çështjet e buxhetit, të projekteve në Infrastrukturë ose ato për çështjet e pronësisë, janë debatuar në mbledhjet e komisioneve të përhershme si edhe në mbledhjet e Këshillit dhe, janë miratuar me votën e shumicës së këshilltarëve sikurse është parashikuar në ligj.

Sikurse cituam më sipër, të gjitha vendimet e Këshillit të Bashkisë, janë depozituar pranë Prefektit të Qarkut për të verifikuar ligjshmërinë dhe, në të gjitha rastet nga ana e tij është konstatuar se kanë qënë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli Bashkisë bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, për problematikat të ndryshme, para çdo vendimmarrje për të cilat është i detyrueshëm konsultimi publik, ka organizuar së bashku me Administratën e Bashkisë dëgjesa publike me grupet e interesit si dhe me publikun e gjërë. Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar dhjetë dëgjesa publike, dhe kanë marrë pjesë antarë të komunitetit të interesuar, përfaqësues të OJF-ve që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Vlorës, këshilltar etj. Duhet theksuar se nga këto dëgjesa, shumica lidhen me buxhetin e Bashkisë për vitin 2026 si dhe për PBA 2026-2028.

Komisionet

Një rol të rëndësishëm për vendimmarrjen e këshillit, kanë luajtur edhe zhvillimi para mbledhjes së Këshillit i mbledhjeve të Komisioneve të përhershme. Në mbledhjet e Komisioneve, janë diskutuar propozimet dhe problematikat e paqarta të projektvendimeve të paraqitura nga Administrata të cilat në bashkëpunim me administratën e Bashkisë janë adresuar dhe qartësuar përpara vendimmarjes së Këshillit.

-Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 39 mbledhje të Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

Pavarësisht Rendit të Ditës të mbledhjeve të Këshillit, Komisioni juridik, i rendit dhe sigurisë publike dhe ai për çështjet ekonomike, financiare dhe privatizimet si rregull në tërësi janë mbledhur para cdo mbledhje të Këshillit. Ndërkohë komisionet e tjera janë mbledhur sipas rastit, në funksion të fushave që mbulojnë dhe objektit të projektvendimeve të cilat janë paraqitur për tu shqyrtuar dhe miratuar në mbledhjet përkatëse.

Konkretisht mbledhjet e Komisioneve të Perherëshme të Këshillit Bashkisë për 2025 janë zhvilluar si më poshtë :

Nr	Emërtimi i Komisionit	Mbledhjet e Zhvilluara
1	Komisioni Juridik i Rendit dhe Sigurisë	12
2	Komisioni për Çështjet e Ekonomisë, Financave dhe privatizimet	8
3	Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Infrastrukturës dhe Strehimit	2
4	Komisioni për Zhvillimin Urbanistik dhe Ndërtimet	3
5	Komisioni për Arsimin, kulturën dhe sportet	4
6	Komisioni Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujrave	3
7	Komisioni i Barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale	3
8	Komisioni i Mandateve dhe rregullores	4
9	Gjithësej	39

Pavarësisht sa më lart, në varësi të rendit të ditës dhe objektit të projektvendimeve, gjatë vitit 2025 është parashikuar nga Kryesia e Këshillit zhvillimi i mbledhjeve të komisioneve në 58 (pesëdhjetë e tetë) raste por që, për mosplotësim të kuorumit në 19 (nëntëmbëdhjetë) raste nuk janë zhvilluar. Kjo kërkon një angazhim më të mirë të këshilltarëve anëtarë të komisioneve përkatëse, me qëllim që, diskutimet e planifikuara ose të kërkuara të komisioneve të mos dështojnë për mosplotësim të kuorumit të domosdoshëm.

I njëjti angazhim duhet edhe për pjesëmarrjen e këshilltarëve në mbledhjet e këshillit pasi, sikurse theksuam më lart, për mosplotësim të kuorumit mbledhja e këshillit për muajin prill, nuk arriti të zhvillohej në ditën e parashikuar .

Gjithashtu sikurse theksuam më lart, në dy raste projektvendimet e paraqitura për miratim në Këshillin Bashkiak, nuk janë miratuar në mbledhjen e radhës për mosplotësim të kuorumit të domosdoshëm. Kjo ka ndodhur pasi për arsye të ndryshme, disa këshilltarë nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje të Këshillit. Është detyrë e secilit këshilltar që, si në mbledhjet e komisioneve të përherëshme edhe në mbledhjet e këshillit, të jenë pjesëmarrës pasi jemi të mandaturat si përfaqësues të komunitetit.

Nga një vështrim i përgjithshëm rezulton se, nga 51 anëtarë të Këshillit të Bashkisë ,vetëm 6 këshilltarë nuk kanë bërë asnjë mungesë në mbledhjet e Këshillit, 11 këshilltar kanë bërë deri në

2 mungesa, ndërkohe që disa këshilltarë kanë munguar më shumë se 5-6 here mbledhje të Këshillit, por pa tejkaluar numrin e mungesave që bëhet shkak për përfundimin para afatit të mandatit të këshilltarit.

Transparenca dhe bashkëpunimi me institucionet dhe komunitetin

Në kuadër të programit të transparencës, aktivitetet e këshillit dhe cdo vendimmarrje e tij transmetohen në facebook live dhe në mediat lokale në kohë reale. Nga sondazhet e bëra rezulton se gjatë vitit 2025, mbledhjet e këshillit janë ndjekur rregullisht nga publiku në kohë reale por dhe në vijimësi. Gjithashtu, projektvendimet, vendimet e këshillit, procesverbalet e mbledhjeve, njoftimet për mbledhjet e këshillit dhe të komisioneve të përhershme si dhe njoftimet për konsultimet publike, publikohen në fqen zyrtar të Bashkisë www.vlora.gov.al si dhe në faqen www.vendime.al/vlorë. Këtij qëllimi i kanë shërbyer edhe pjesmarrja e stafit të këshillit dhe këshilltarëve sips rastit, në veprimtaritë e trainimit të organizuara nga Projekti “Bashki të Forta” si në Durrës, Delvinë, Vlorë, në Prefekturën Vlorë etj.

Gjithashtu këtij qëllimi i ka shërbyer edhe pjesmarrja e stafit dhe këshilltarëve, në takimet e organizuara nga Organizata të Shoqërisë Civile, ku janë diskutuar çështje të tilla si, pjesmarrja e komunitetit në vendimmarrje, bashkëpunimi i Këshillit të Bashkisë me Shoqërinë Civile, vlerësimin të kërkesave dhe propozimeve të publikut para vendimmarrjeve të këshillit e tëj. Po në funksion të parimit të transparencës nga Stafi i Këshillit, i janë dërguar vecmas Organizatave të Shoqërisë Civile që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Vlorës dhe Deputetëve të Qarkut Vlorë, data e mbledhjes së këshillit, rendi i ditës i mbledhjes si dhe datat e zhvillimit të mbledhjeve të komisioneve të përhershme të këshillit.

Gjatë periudhës raportuese, rëndësi i është kushtuar edhe trajtimit të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve si dhe komunikimit me institucioneve të tjera për çështje që lidhen me kompetencat e Këshillit të Bashkisë. Është e rëndësishme të theksojmë se, sikurse parashtroam në hyrje të këtij raportimi edhe kërkesat e këshilltarëve të shprehura në mbledhjet e këshillit ose në forma të tjera, i janë përcjellë Administratës së Bashkisë cdo muaj dhe rast pas rasti. Është detyrim i saj të vlerësojë dhe të kthejë përgjigje për çdo kërkesë, pasi, konstatohen vonesa në përgjigje ose ka raste kur nuk kthehen përgjigje.

Shpenzimet e Këshillit.

-Gjatë vitit 2025, nga shpenzimet e planifikuara në buxhetin e bashkisë në funksion të zhvillimit normal të punës dhe aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë, rezulton se në tërësi janë realizuar vetëm ato për paisje zyre dhe kancelari. Kërkesat për krijimin e kushteve normale në sallën e mbledhjeve të këshillit si, vendosja e mikrofonave dhe sistemi i ngrohjes, edhe pse ishin të parashikuara në buxhet, për arsye të ndryshme nuk u realizuan. Për rrjedhojë, është detyrim i saj të realizojë sa më shpejt të jetë e mundur procedurat e prokurimit për të siguruar mikrofonat dhe sistemin ngroje, referuar edhe ankesave dhe shqetësimeve të vazhdueshme të këshilltarëve, Kryesisë së Këshillit ose Grupeve të këshilltarëve. Gjithashtu, për arsye të ndryshme, edhe shpenzimet e parashikuara në buxhet për

vizita studimore dhe trajnime , nuk u realizuan. Po ashtu shpenzimet për auditime nga ekspertë të jashtëm ,nuk u realizuan, pasi nga Këshilli i Bashkisë, nuk është parë e arsyeshme, kryerja e një procedure të tillë.

Nga sa më lartë mund të themi se, puna dhe vendimmarrja e Këshillit të Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2025 mund të vlerësohet pozitivisht.

Njëkohësisht është detyrë e sejcilit këshilltar që për periudhën në vijim të rris më shumë ndjenjën e përgjegjësisë vecanërisht për të evituar mungesat dhe ruajtjen e etikës gjatë komunikimit në mbledhjet e këshillit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR
Elpiniq Mërkuri

